

## TERMA REFERENCE

### ANALIZIM TË DHËNASH DHE SHKRIM RAPORTI MBI GJETJET E MONITORIMIT

<b>Pozicioni / Shërbim</b>	Ekspert i jashtëm për analizim të dhënash dhe shkrim raporti mbi gjetjet e monitorimit
<b>Titulli i Projektit</b>	“Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike”
<b>Mbështetur:</b>	Projekti financohet nga Ambasada Britanike në Shqipëri
<b>Lloji i Kontratës :</b>	Kontratë shërbimi – ekspert për analizim të dhënash dhe shkrim raporti mbi gjetjet e monitorimit
<b>Periudha e kontratës</b>	Shkurt 2024
<b>Ditët e punës</b>	15 ditë pune

#### Informacion i përgjithshëm për Projektin

- Projekti ka për qëllim të kontribuojë në parandalimin dhe shfaqjen e ndikimeve të panevojshme përmes angazhimit, monitorimit, ngritjes së kapaciteteve dhe ndërgjegjësimit, si dhe përmes informimit të një grupi të rëndësishëm të aktorëve dhe palëve të interesuara për të siguruar implementimin e drejtë dhe të lirë nga ndikimet e panevojshme në procesin zgjedhor.
- Instituti i Studimeve Politike synon të monitorojë transparencën dhe llogaridhënien në zbatimin e standardeve të dekriminalizimit dhe integritetit për kandidatët, subjektet zgjedhore dhe institucionet e përfshira në procesin zgjedhor dhe produktet e tij zgjedhore në periudhën paszgjedhore.

## Qëllimi i shërbimit

Në kuadër të implementimit të projektit “*Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike*”, ku një ndër aktivitetet kryesore tij është monitorimi i standardeve të dekriminalizimit dhe integritetit në 61 bashki dhe këshillave bashkiakë në Dibër, Kukës and Shkodër, Instituti i Studimeve Politike kërkon **ekspert të jashtëm për analizim të dhënash dhe shkrim raporti mbi gjetjet e monitorimit.**

## Eksperti do të jetë përgjegjës për:

- Analizën e të dhënave të monitorimit mbi vendimet e SPAK për zyrtarët e lartë, me në fokus Dibrën, Kukësin dhe Shkodrën;
- Analizën e të dhënave të monitorimit mbi mbledhjen e të dhënave dhe formularëve të dekriminalizimit për kryetarët e bashkive dhe anëtarët e Këshillit Bashkiak, me në fokus Dibrën, Kukësin dhe Shkodrën;
- Evidentimin e gjetjeve dhe zhvillimin e analizës mbi bazën e tyre;
- Hartimin e konkluzioneve dhe rekomandimeve të dala nga monitorimi;
- Ofrimin e angazhimit profesional në bashkëpunim me stafin e ISP për sugjerime, paqartësi, materiale shtesë, etj;
- Adresimin e gjetjeve, reflektimin e sugjerimeve të ISP, në variantin përfundimtar të dokumentit;
- Të mundësojë dorëzimin e timesheet-eve, duke raportuar mbi orët e shërbimit të realizuara në përputhje me qëllimin e shërbimit të kërkuar, apo çdo dokument shoqërues që do të duhet për raportimin e shërbimit;
- Të jetë disponibël për të përmbushur detyrimet lidhur me shërbimin e kërkuar sipas afatit kohor të përcaktuar;
- Të mbrojë konfidencialitetin e informacionit dhe të dhënave që do mund të merren gjatë ofrimit të shërbimit.

## Profili i ekspertit:

- Të ketë përvojë profesionale mbi 5-vjeçare në lidhje me proceset zgjedhore;
- Të ketë njohuri shumë të mira të Kodit Zgjedhor, praktikave dhe rregulloret e KQZ;
- Të jetë njohësi i mirë i legjislacionit të partive;
- Të ketë eksperiencë bashkëpunimi me shoqërinë civile;
- Aftësi të shkëlqyera analizuuese dhe hulumtuuese;

- Shumë i/e organizuar në nivel detyre dhe projekti.

### Aftësitë individuale:

1. Të jetë i/e pavarur, i/e paanshëm dhe me integritet;
2. Të ketë aftësi analitike dhe mendim kritik;
3. Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi dhe bashkëpunimi në ekip dhe jo vetëm;
4. Të jetë i/e përgjegjshëm për respektimin e detyrave dhe afatet e vendosura

### Dokumentet e Aplikimit:

Aplikantët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e ekspertit duhet të dorëzojnë:

1. CV e detajuar;
2. Letër motivimi;
3. Ofertë Financiare;
4. Punë të ngjashme të realizuara më parë nga kandidati.

### Kostot dhe Pagesat

Kostoja dhe mënyra e pagesës përcaktohet pas lidhjes së Kontratës së Shërbimit dhe pas paraqitjes së raportit nga eksperti për punën e kryer.

Aplikimi duhet të dërgohen në një nga 3 variantet, jo më vonë se data 07/02/2024 ora 16:00

1. **Në formë elektronike** në adresën e e-mailit [contactaips@gmail.com](mailto:contactaips@gmail.com),
2. **Me postë** me zarf të mbyllur titulli i projektit sipër “ *Ekspert i jashtëm për analizim të dhënash dhe shkrim raporti mbi gjetjet e monitorimit. Të mos hapet përpara datës së tenderit.*”, në adresën: Rr “Luigj Gurakuqi”, Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë
3. **Dorazi** me zarf të mbyllur titulli i projektit sipër “ *Ekspert i jashtëm për analizim të dhënash dhe shkrim raporti mbi gjetjet e monitorimit. Të mos hapet përpara datës së tenderit.*”, në adresën: Rr "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë

(Lutemi specifikoni qartë e-mail ose një nr. kontakti.)

**Instituti i Studimeve Politike**